



# FORÇA JONË

\* \* \* Viti I • Nr. 3 • Gusht 2012 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës \* \* \*

## Shefi i Shtabit të Ushtrisë së Italisë pritet me nderime nga Garda Ceremoniale e FSK-së

Ministri i FSK-së, Agim Çeku, ka prit shefin e Shtabit të Ushtrisë së Italisë, gjeneralin Abrate Biagio. Ministri Çeku, me këtë rast, ka falënderuar Shefin e Shtabit të Ushtrisë së Italisë për ndihmën që Italia vazhdimisht po jep për Kosovën dhe FSK-në. Pastaj e njoftoi me të arriturat e FSK-së, për plotësimin e Kapaciteteve Operacionale dhe detyrat që e presin FSK-në, në të ardhmen, si; rishikimin e strategjisë së sigurisë, bashkëpunimin e FSK-së me shumë shtete të rajonit dhe të botës etj. Në fund ministri Çeku e vlerësoi lartë bashkëpunimin e FSK-së me KFOR-in dhe ekipet këshilluese të NATO-s. Po ashtu u diskutuan edhe mundësitë e trajnimit të pjesëtarëve të FSK-së në Itali, në

fusha të caktuara profesionale. Ndërsa, shefi i Shtabit të Ushtrisë së Italisë, gjenerali Abrate Biagio, ka shprehur gatishmërinë për ta ndihmuar edhe më tej FSK-në në të gjitha fushat që ka nevojë. Të dy palët u pajtuan se ky bashkëpunim i mirë do të mund të thellohej dhe zyrtarizohej edhe më mirë përmes nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të dy ministrive. Në takim morën pjesë, zëvendës ministri Shemi Veseli, gjeneralët: Imri Ilazi, Gëzim Hazrolli dhe koloneli Ilir Qeriqi. Ndërsa shefi i Shtabit të Ushtrisë së Italisë, gjenerali Abrate Biagio shoqërohej nga gjeneralët: Luigji F. De Leverano, Michele Cittadella dhe oficerë të tjerë madhorë.



## Zëvendësambasadorja e SHBA-ve vizitoi MFSK-në



Ministri i FSK-së Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së gjeneraljtënant Kadri Kastrati kanë prit në takim zëvendës ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në

Prishtinë, zonjën Kelly Degnan. Ministri Agim Çeku fillimisht i ka uruar zonjës Degnan, detyrën e re të zëvendës ambasadores në Prishtinë si dhe e ka njoftuar me të arriturat e FSK-së.

Qëllimi i vizitës së zëvendës ambasadores Degnan në FSK, kishte karakter njoftimi me detyrën e re dhe për vazhdimin e bashkëpunimit të Ambasadës së SHBA-ve edhe të FSK-së.

## Ministri Agim Çeku ka dekoruar ambasadorin Dell me medalje për "Shërbim merit"

FAQE 3




Një delegacion i Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë vizitoi FSK-në

## Ministri i FSK-së, Agim Çeku falënderon Shqipërinë për ndihmën dhënë FSK-së

Zëvendësministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë Arian Starova ka qëndruar për një vizitë pune, në Ministrinë e Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) ku u prit nga ministri Agim Çeku dhe zëvendësministri Bejtush Gashi.

Ministri Çeku, me këtë rast, e ka falënderuar zv. ministrin Starova për ndihmën që Shqipëria po i jep Forcës së Sigurisë të Kosovës si dhe e ka njoftuar me trajnimet, shkollimin dhe bashkëpunimin e FSK-së, në rajon dhe më gjerë. Gjithashtu zëvendës ministri Arian Starova në emër të Ministrisë dhe popullit të Shqipërisë e ka falënderuar ministrin Çeku për ndihmën që FSK-ja i ka dhënë Shqipërisë, gjatë vër-

shimeve në Shkodër, etj. Më pastaj, ka vazhduar takimi i të dy grupeve punuese të udhëhequr nga zv. ministri Bejtush Gashi, Haxhi Shala drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane dhe koloneli Ilir Qeriqi, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri të FSK-së, dhe delegacioni i Mbrojtjes së Shqipërisë kryesohej nga zv. ministri Starova, Adriatik Mema, drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Mbrojtjes dhe major



Ermir Begaj, specialist në Drejtorinë për Marrëdhënie me Jashtë.

Qëllimi i takimit të grupeve

punuese të dy delegacioneve ishte implementimi i planit të veprimit të hartuar kohë më parë, nga ministri Çeku dhe Imami, për cak-

timin e fushave të bashkëpunimit në mes të dy ministrive. Delegacioni nga Shqipëria, ka vizituar edhe Komandën e Forcave Tokësore (KFT) ku u prit nga zëvendëskomandanti i saj, gjenerali brigade Gëzim Hazrolli i cili përmes një brifingu e njoftoi zëvendës ministrin Starova me të arriturat dhe objektivat e FSK-së, në ngritjen e kapaciteteve të FSK-së, etj. Zëvendës ministri Arian Starova pas takimeve është shprehur i impresionuar me të arriturat që ka bërë FSK-ja, për këtë periudhë të shkurtër kohore si dhe ka premtuar që edhe në të ardhmen Ministria e Mbrojtjes së Shqipërisë do ta ndihmojë FSK-në.

Shefi i Ushtrisë së Maqedonisë qëndroi për vizitë në Ministrinë për FSK-në

## Bashkëpunim i frytshëm në mes të FSK-së dhe Ushtrisë së Maqedonisë

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati priti në vizitë shefin e Ushtrisë të Republikës së Maqedonisë, gjeneral major Goranqo Koteski si edhe delegacionin e lartë të Ushtrisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Maqedonisë. Gjeneral Koteskit iu rezervua pritje me ceremoni zyrtare nga Garda Ceremoniale e FSK-së.



Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati dhe me pas ministri i FSK-së, Agim Çeku, në Ministrinë e FSK-së, zhvilluan takime të ndara me shefin e ushtrisë së Maqedonisë.

Në të dyja takimet ministri Çeku dhe gjeneral Kastrati e njoftuan gjeneral Koteskin me aktivitetet dhe zhvillimet në FSK si edhe me planet dhe perspektiven e mëtejshme të saj. Po ashtu, ministri dhe komandanti u shprehën se marrëdhëniet dhe bashkëpunimi ndërmjet FSK-së dhe Ushtrisë së Maqedonisë janë në nivel të lartë dhe shprehën gatishmërinë për thellim të bashkëpunimit të mëtejshëm, bazuar në raportet

e mira dhe në konkretizim të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet dy forcave dhe të dy vendeve.

Pas takimeve me ministrin Çeku dhe komandantin e FSK-së gjeneral Kastratin, gjeneral major Goranqo Koteski tha se fushat e bashkëpunimit ndërmjet Ushtrisë së Maqedonisë dhe FSK-së janë shumë të gjera dhe konkrete. Gjeneral Koteski po ashtu deklaroi se Ushtria e Maqedonisë ka ofruar poligonin ushtarak në Krivolak për nevoja të FSK-së si edhe

ritheksoi gatishmërinë e tyre për shkollimin e kadetëve të FSK-së (nga radhët e komuniteteve), në Akademinë Ushtarake në Shkup. Më tej shefi i Ushtrisë së Maqedonisë tha se shpresojmë që sa më shpejt FSK-ja të jetë eksportues edhe më i madh i paqes në rajon e më gjerë. Delegacioni i lartë i Ushtrisë në krye me gjeneral Koteskin vizituan Komandën e Forcave Tokësore, përkatësisht Qendrën për Studime Universitare të FSK-së në kazermin "Adem Jashari" në Prishtinë.



## Ministri i FSK-së, Agim Çeku priti në vizitë lamtumirës atasheun ushtarak të Holandës

Me rastin e përfundimit të mandatit në cilësinë e atasheut ushtarak të Holandës, nënkolonel Ton Koedam si dhe në prezencën e ambasadorit të Holandës në Kosovë, z. Robert Bosch. Në takim ishte prezent edhe ambasadori i Holandës në Kosovë z. Robert Bosch, ministri Çeku shprehu falënderimin e tij dhe të FSK-së për bashkëpunimin e ndërsjellët në shumë fusha, në mes të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Ushtrisë së Holandës. Ministri Çeku shprehu gatishmërinë e tij për vazhdimin dhe forcimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen. Holanda gjatë kësaj kohe ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për FSK-në, duke theksuar pjesëmarrjen në marshin tradicional të pjesëtarëve të FSK-së në Njemengen të

Holandës, trajnimin për zhytës të pjesëtarëve të Kërkim-Shpëtimit në Vlorë të Shqipërisë, donacionet me pajisje për sallën sportive në KDS-Ferizaj e Istog dhe disa projekte humanitare. Ndërkaq nënkolonel Koedam tha se ka qenë kënaqësi të jesh atashe ushtarak në Kosovë dhe të bashkëpunosh me FSK-në. Gjatë kësaj kohe Forca e Sigurisë së Kosovës ka pasur ngritje të jashtëzakonshme në shumë fusha. Holanda ka mbështetur FSK-në në shumë trajnime dhe projekte humanitare dhe kjo ndihmë do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Ky bashkëpunim intensiv bazohet në memorandumin e bashkëpunimit në mes të MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Holandës të nënshkruar më 23 dhjetor 2009 dhe nënshkrimin e planit bilateral në vitin 2011.

Në Akademinë për Informim dhe Komunikime të Ushtrisë Gjermane, në Strausberg

## U mbajt seminar për personelin e MFSK-së; Forcat e Armatosura në Demokraci

Në kuadër të bashkëpunimit bilateral mes Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Gjermanisë, në Berlin, me ftesë të ministrisë së Mbrojtjes të Gjermanisë, qëndroi një delegacion i lartë i Ministrisë dhe i Forcës së Sigurisë së Kosovës, në një seminar nga data 02-07.07.2012 të mbajtur në Akademinë për Informim dhe Komunikime të Ushtrisë Gjermane në Strausberg dhe Berlin. Pjesëmarrësit e seminarit: Haxhi Shala, drejtor i Drejtorisë për Politika dhe Plane, kryesues i delegacionit, Gjeneralbrigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë së Operacioneve, kolonel Naim Haziri, shef i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore, (KFT) kolonel Ilir Qeriqi, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri, kolonel Skënder Zhitia, drejtor i Departamentit të Personelit, Farije Sadiku, drejtor i Departamentit për Menaxhimin e Financave, Zijadin Bajqinca, drejtor i Departamentit të Logjistikës, Florin Hoxha, asistenti i Sekretarit të Përgjithshëm dhe nënkolonel Haki Hoti, shef i Sektorit për



Plane, Programe dhe Analiza. Tema bosht e seminarit ishte: Forcat e armatosura në demokraci, si dhe çështjet e tjera që u diskutuan në këtë seminar, kishin të bëjnë me demokracinë në forcat e armatosura, respektivisht me udhëheqjen e brendshme të Forcave të Armatosura. Gjithashtu u trajtuan edhe shumë çështje që kanë të bëjnë me rregullat e veprimit, kodin disiplinor, ligjet themelore dhe zhvillimin e karrierës në Forca të Armatosura. Përveç pjesës teorike dhe praktike, seminaristët realizuan takime me interes të veçantë, në

Parlamentin Gjerman, në Shoqatat e Bundeswehrtit Gjerman, ndërsa në Parlamentin Gjerman, delegacioni i MFSK-së, u prit nga njohësi i mirë i Kosovës, deputeti Schwarz. Gjatë mbajtjes së këtij seminar, delegacioni i MFSK-së u informua edhe mbi proceset e zhvillimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Gjermanisë. Seminarin ishte i një niveli shumë të lartë dhe me interes të veçantë, për delegacionin e MFSK-së, të cilët u njohën me përvojat e ushtrisë gjermane dhe gjatë seminarit pati edhe shkëmbime të përvojave nga të dyja palët.

## Caktojnë prioritetet e bashkëpunimit për vitin 2013

Ministri i FSK-së, Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati kanë pritur në takime të ndara një delegacion të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë. Komandanti i FSK-së gjeneral Kastrati e ka pritur delegacionin shqiptar të kryesuar nga Rezart Bejkaj, drejtor për Marrëdhënie me Jashtë në Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë. Po ashtu edhe ministri Agim Çeku së bashku me zëvendësministrin Shemsi Veselin dhe kolonel Ilir Qeriqin e kanë pritur dhe kanë zhvilluar një takim

pune me delegacionin e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë. Ministri dhe komandanti i FSK-së e kanë njoftuar delegacionin e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, për zhvillimet dhe të arriturat e FSK-së. Më pastaj delegacioni i Republikës së Shqipërisë ka mbajtur takime pune në Ministrinë e FSK-së, me departamentet përkatëse, ku kanë biseduar për realizimin e planit dypalësh të bashkëpunimit për këtë vit si dhe planifikimin e planit të bashkëpunimit për vitin 2013.



Ministria e FSK-së organizoi ceremoni lamtumirëse për ambasadorin Kristofer Dell dhe kolonel Arthur Beauchamp

## Në Ministrinë e FSK-së u prit me nderime ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, z. Kristofer Dell



të sigurta me ardhjen e tij. E dija se Çeku ishte njeriu i duhur në kohën e duhur për ta udhëhequr edhe një herë transformimin e FSK-së, sepse ai gjatë transformimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Trupat Mbrojtëse të Kosovës ka qenë në krye të kësaj ushtrie dhe pastaj në krye të trupave të FSK-së. Dhe pikërisht është njeriu i duhur për ta çuar përpara FSK-në, deri sa të bëhet përmbyllja e Pavarësisë së mbikëqyrrur.

Derisa i shoh këtu të gjitha të arriturat e FSK-së, siç ishte aksioni i shpëtimit në Dragash, apo ndihma e juaj në Shqipëri, për t'u përballur me vërshimet atje, si dhe aksionet e tjera të zjarrëfikje dhe të arriturat e tjera të panumërta, e di se jeni duke u zhvilluar në një forcë të tillë që i nevojitet Kosovës, Ju po bëheni pikërisht një forcë shumetnike, profesionale e sigurisë, e cila është simbol i Kosovës dhe asaj çka aspiron të bëhet.

Shpresoj se në të ardhmen do t'ju shohim krah për krah me popujt e tjerë të Shteteve të Bashkuara dhe të shteteve aleate të NATO-s, shteteve në rajon dhe më gjerë, tha pos tjerash ambasadori Dell. Në fund ambasadori Dell dhe koloneli Beauchamp kanë falënderuar ministrin Çeku dhe kanë uruar FSK-në për arritje të mëtejme.

Në ceremoninë e pritjes të ambasadorit Dell dhe atasheut ushtarak, kolonel Arthur Beauchamp, morën pjesë edhe zv. ministrit; Shemsi Veseli, Bejtush Gashi dhe Slavisha Filipoviç, zëvendës komandanti i KFT gjeneral Gzim Hazrrolli, gjeneral Imri Ilazi, gjeneral Enver Cikaqi, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylja, si dhe oficerët e lartë të FSK-së, drejtor të departamenteve dhe drejtorive të MFSK-së, përfaqësuesit e Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrje të FSK-së, përfaqësuesit e KFOR-it, këshilltarët e Ekipit Këshillues të NATO-s në MFSK, si dhe atashetë ushtarak në Kosovë.

Për nder të ambasadorit amerikan ishin rreshtuar kuadratet e FSK-së. Me ekzekutimin e himnit të SHBA-së dhe të Kosovës filloi zyrtarisht ceremonia lamtumirëse për ambasadorin Dell dhe atasheun ushtarak amerikan, kolonelin Arthur Beauchamp. Ministri Agim Çeku ka dekoruar ambasadorin Dell me medalje për "Shërbim meritot", ndërsa atasheun ushtarak kolonelin Arthur Beauchamp me medalje për "Shërbim të shquar" Në fjalën e tij, ministri i FSK-së, Agim Çeku, me këtë rast, tha:

Jemi këtu për ta falënderuar dhe për t'i shprehur respektin tonë z. Kristopher Dell, ambasadori i SHBA-ve dhe kolonelit Arthur Beauchamp, atashe ushtarak i SHBA-ve. Këta dy burra, që ne po i nderojmë sot, nuk na kanë nderuar vetëm neve, por në radhë të parë e kanë nderuar vendin e tyre me punën e përkushtuar dhe plot entuziazëm për Kosovën dhe popullit tonë.

Neve na vjen keq që misioni i ambasadorit Dell dhe i kolonelit Beauchamp në Kosovë po përfundojnë, por kontributi i tyre do të mbetet gjithmonë me ne.

*Zotëri ambasador,*

Gjatë misionit tuaj në Kosovë, ju keni qenë gjithmonë të fokusuar në forcimin e partneritetit dypalësh (bilateral) në mes vendeve tona. Me

përkrahjen tuaj, Programi i Partneritetit Shtetëror me Gardën e Kombëtare të Ajovës dhe të FSK-së është realizuar dhe tash po zbatohet me sukses. Kemi realizuar një qëllim dhe një ëndërr të kamotshme. Përkrahja juaj për të filluar rishikimin strategjik të sektorit të sigurisë ka qenë vendimtare.

Ju na mbështetët që për herë të parë institucionet e Kosovës të ndërtojnë institucione të mbrojtjes dhe sigurisë çfarë i nevojiten Kosovës.

Ne kemi pranuar vitin e kaluar një donacion prej 2.5 milionë dollarësh për projektin e sistemit për menaxhimin e informatave. Ky projekt është bërë në partneritet të ngushtë me NATO-në.

Ambasadori Dell, po ashtu, ishte shtytësi kryesor që për herë të parë të nënshkruhet Marrëveshja e Statusit të Forcave në mes të Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara. Gjatë takimit tim me zëvendës sekretarin gjeneral të NATO-s në qershor, Kosova është lavdëruar për progresin e FSK-së. Ky progres i zhvillimit të FSK-së në një forcë kompetente, të aftë dhe profesionale është arritur me përkrahjen e pa rezervë të tuajën dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Amerika do të jetë vend të cilin populli i Kosovës gjithmonë do ta ketë në zemër. Ne do t'i kujtojmë fjalimin dhe mesazhet e juaja

frymëzuese në ceremoninë e nderimit të Komandës në FSK. Ambasador, ju faleminderit për bashkëpunimin dhe miqësinë tuaj të jashtëzakonshme, përshëndeti në fund ministri Agim Çeku.

Ministri Çeku me një fjalë rasti falënderoi edhe kolonelin Arrthur Beauchamp, i cili ka dhënë kontribut të veçantë në ndihmë të FSK-së.

Koloneli Beauchamp ka qenë forcë shtytëse për dërgimin e Atasheut të Parë nga Republika e Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Lidershipi i tij ishte i rëndësishëm në ndihmë të FSK-së dhe Qeverisë së Kosovës, për të siguruar përkrahje nga Departamenti i Mbrojtjes për të asistuar FSK-në dhe Qeverinë në Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë. Vizioni strategjik i kolonelit Beauchamp ka qenë thelbësor në ndihmë të FSK-së, për t'i përmirësuar kapacitetet e saj, në dy fusha të veprimit: Evitimin e Rreziqeve nga Mjetet e Pashpërthyer si dhe për Kërkim-Shpëtim. Koloneli Beauchamp ka zhvilluar një plan strategjik, ku ka ndihmuar në marrjen e një fondi prej 5 milionë dollarësh, për t'i trajnuar dhe pajisur njësitet e FSK-së, për deminim, kërkim-shpëtim etj. Gjatë kohës së tij, mbi 200 pjesëtarë të FSK-së kanë kryer trajnime, ky është numri më i lartë i pjesë-

tarëve të FSK-së që kanë kryer trajnime të nivelit të lartë profesional të FSK-së.

Koloneli Beauchamp ndihmoi për të ndërtuar Korpusin e nën-oficerëve profesional të FSK-së.

Lidershipi i kolonelit Beauchamp ka qenë i rëndësishëm në pranimin e rekomandimit pozitiv mbi Kapacitetet e Plota Operacionale që është dhënë nga komandanti i KFOR-it.

"I dashuri Kristofer, i dashuri Arthur, falënderimet më të ngrohta për ju, punën i dhe kontributin tuaj të jashtëzakonshëm. Gjithmonë ka qenë mirë kur e dinim se mund të llogarisnim tek ju për të shkuar edhe një hap më tutje. Ju do të na mungoni, por entuziazmi dhe përkushtimi i juaj do të kujtohen përgjithmonë në Kosovë. Ju do të jeni të mirëseardhur dhe ju presim që të ktheheni përsëri. Kosova është dhe do të jetë shtëpia e juaj"- tha në fund ministri Agim Çeku.

Duke përshëndetur ministrin Çeku, gjeneralët, oficerët, aleatët e NATO-s, ambasadori Dell tha: Me ministrin Çeku fillimisht kemi punuar kur është përgatitur të marr udhëheqjen e TMK-së, si komandant i parë i asaj trupe. Unë kam qenë shumë i gëzuar kur ministri Çeku e ka marrë detyrën e kësaj ministrie, në shkurt të vitit 2011. E dija se FSK-ja ishte në duar



18 pjesëtarë të FSK-së përfundojnë me sukses marshimin në Holandë

## FSK-ja kthehet me medalje nga marshimi në Holandë

Kontingjenti i FSK-së, për herë të dytë, kthehet me sukses të plotë, nga Holanda, ku mori pjesë në marshin tradicional të 96-tin me radhë të mbajtur në qytetin Nijmegen.

Marshi tradicional u mbajt, për katër ditë me radhë, nga data 19-23 korrik 2012, në qytetin Nijmegen të Holandës. Sipas rregullave të marshit, çdo ditë ekipet kanë marshuar nga 40 kilometra. Në këtë marshim kanë marrë pjesë pjesëmarrës nga shumë shtete të NATO-s dhe të shteteve të tjera të botës. Forcën e Sigurisë të Kosovës, këtë vit, e kanë përfaqësuar tetëmbëdhjetë pjesëtarë, në mesin e tyre morën pjesë edhe dy pjesëtarë të FSK-së.

Kontingjenti i FSK-së edhe këtë vit, është kthyer me sukses të plotë, të gjithë pjesëtarët e FSK-së si njësitë arrijnë me kohë në cak. Ndërsa vitin e kaluar njëjsti i FSK-së shënoi suksesin më të madh, duke hyrë në histori të



it me sukses të këtij marshimi. Për arritjen e këtij suksesi, majoor Krasniqi, ka thënë se: "Motivimi, disiplina, entuziazmi kanë qenë faktorët kryesor që kanë bërë që Kontingjenti i FSK-së të zë vendin e parë, por ka qenë edhe gatishmëria e ushtarëve për të realizuar misionin e marrë nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Kadri Kasrati. Gjatë gjithë kohës, që nga nisja, zbarrimi, mbajtja e garës, kontingjenti i FSK-së ka qenë në nivel shumë të lartë të kryerjes së detyrave. Me këtë fitore konsideroj se FSK-ja po bënë histori që dy vjet treshi duke zënë vendin e parë", thotë në fund majoor Krasniqi.



shtet e ka shënuar në historinë 95 vjeçare të këtij marshimi, ku të gjithë pjesëmarrësit si ekip e kalojnë marshimin katërditor.

Kjo është hera e dytë që njëjsti i FSK-së e arrin suksesin e vitit të kaluar, komplet të kalojë shtegun prej 160 km. Për të përcjellur finalen e marshimit, në Nijmegen, kishin marrë pjesë: ambasadori i Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Holandës, z. Nexhmi Rexhepi dhe zëvendës komandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigadë Gëzim Hazroli, të cilët së bashku kanë bërë edhe shpërndajen e medaljeve për të gjithë pjesëtarët e kontingjentit të FSK-së, pas përfundim-

këtij marshimi tradicional si ekipi i dytë që kishte arrit të hynte në cak.

Marshimi ka pasur rregullat e veta të rrepta, na thotë majori Ali Krasniqi, udhëheqës i kontingjentit të FSK-së, ku secili ekip është dashtë ta kryejë marshimin në kohën e caktuar dhe si ekip. Marshimi nuk ka qenë garë shpejtësie, se kush po hyn i pari në cak, por, suksesit është matur si ekip, d.m.th. të gjithë pjesëtarët e ekipit është dashur që më kohë të arrijnë në cak.

Kontingjenti i FSK-së është shpërblyer me një medalje si ekipi më i mirë si dhe me medalje individuale.

Sipas statistikave të organizatorit, ekipi i FSK-së, vitin e kaluar, ka arritur suksesin më të madh si ekip që vetëm një

Njësia e zhytësve të FSK-së mbajti trajnimin e koduar "Fokat në veprim" në Liqenin e Batllavës

## 'Fokat në veprim' trajnim profesional i zhytësve nën 30 metra thellësi në ujëra

nderuar me katër medalje gjatë shërbimit të tij në këtë njësi. Valmiri edhe emnin e ka të përbashkët me valët dhe vërtet është si valët e mura.

Gjatë tërë kohës së trajnimit të zhytësve të FSK-së, ishte edhe ekipi monitorues i instruktorëve të NATO-s, të cilët në çdo moment janë përkrahë zhytësve të FSK-së, duke vëzhguar dhe duke i ndihmuar me udhëzime dhe forma të tjera.

Njëjsti i zhytësve të FSK-së ka një bashkëpunim të mirë me përfaqësuesit e NATO-s, kjo u vërtet edhe gjatë bisedave të tyre për zgjedhjen e vendit të trajnimit. Monitoruesit



menaxhuar nga instruktorët e Marnës së Holandës së bashku me njësitin e zhytësve të FSK-së, kanë qenë edhe nga një njësit i zhytësve të ushtrisë së Maqedonisë dhe të Republikës së Shqipërisë.

Zhytësit e FSK-së në këtë trajnim certifikues, kanë arritur sukses të merituar: nëntë prej tyre e kanë fituar titullin zhytës me dy yje dhe katër zhytës me një yll. Në trajnimin e sotëm, që po e mbajnë në Liqenin e Batllavës, kemi angazhuar edhe pesë pjesëtarë të ndryshëm të Komandës së disa rinj, për të cilët janë të domosdoshme trajnimet fillestare bazike. Trajnimi rrifreskues bëhet për të dy nivelet; niveli i zhytësve me dy yje zhvillohet në thellësi nën 30

metra, ndërsa, niveli për fillestarë zhvillohet në thellësi deri në 30 metra.

Vitin e kaluar kemi pasur disa intervenime, në Kosovë dhe jashtë Kosovës, në Shkodër.

Restelica ka qenë njëra nga ngjarjet më të rënda për ne, me vetë faktin se aty, kanë humbur jetën një familje, si pasojë e rritshqijtes së bores, ndërsa, njëjsti kishte arritur që nga gërmadhat e shtëpisë së shembur ta nxjerrë të gjallë vajzën e vetme të kësaj familjeje.

Edhe përkundër mungesës së disa automjeteve me profesionale, ne, po ja dalim mbarë me sukses, ndërthyn në bisedë Valmir Kelmendi, zhytësi më i mirë, i cili për intervenime të ndryshme është

gëjmë të liqeni i Batllavës, i cili neve na i plotëson të gjitha kriteret për një trajnim të suksesshëm.

Njësia e zhytësve den më tani është shpërblyer me shumë medalje për arritje të jashtëzakonshme gjatë intervenimeve të shumta, kudo ku kanë marrë pjesë pjesëtarët e kësaj njësie.

Ndërsa nga Shpella e Zgatarit, e cila është e pa hulumtuar deri më tani dhe me plotë rezizje të paparashikueshme, me një thellësi mbi tetëdhjetë metra, tre pjesëtarë të këtij njësi, arrijnë ta nxjerrin trupin e pajetë të një qytetari. Intervënimi kryhet me sukses dhe për këtë komandanti i FSK-së, gjen-



erallejtënant Kadri Kasrati u ka dhënë medalje tre pjesëtarëve që kanë marrë pjesë në këtë intervenim, Ali Selimit, Valdirin Kelmendit dhe Azem Gashit, me motivacionin për trimëri dhe profesionalizëm.

Komandanti i kërkim-shpëtimit premtoi se së shpejti Njëjsti i zhytësve do t'i ketë edhe instruktorët e vetë në këtë lëmi. Ne së shpejti do ta mbajmë një trajnim për certifikimin e instruktorëve të FSK-së, ku do të marrin pjesë nëntë pjesëtarë të cilët e kanë nivelin me dy yje.

Në fund komandanti i Njësisë së kërkim-shpëtimit, kapiteni Ali Selimi, tregon se, për t'i kryer detyrat sa me më sukses i nevojiten edhe disa mjete teknike; automjete transporti dhe barka për intervenim në ujëra. Ndërsa zhytësi më i mirë është shpallur Valdirin Kelmendi, i cili për meritat të jashtëzakonshme ka marrë katër medalje.



## Ambasada Amerikane e ndihmon FSK-në me pajisje teknike për parandalimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë

**Amerika vazhdimisht po na ndihmon jo vetëm me mjete teknike por edhe me trajnime, me qëllim të profesionalizimit**



Ambasada amerikane i ka dhuruar Qeverisë së Kosovës pajisje teknike në vlerë prej 364 mijë dollarësh. Ceremonia e dorëzimit të donacionit u mbajt në Policinë e Kosovës, në Vushtrri, ku morën pjesë; zv.ambasadorja e Amerikës, zonja Kelly Degnan, gjeneral brigade Imri Ilazi nga FSK-ja, Fehmi Fejza nga AMRK-ja dhe Dejan Jankoviç nga Policia e Kosovës.

Me këtë rast zëvendës ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zonja Kelly Degnan tha, se ndihet e

lumtur që po e ndihmon Qeverinë e Kosovës me këtë donacion në vlerë mbi 364 mijë dollarësh, mjete këto të sofistikuara për inspektimin dhe detonimin, pajisje për parandalimin e armëve të shkatërrimit në masë të dhuruara nga Departamenti i Shtetit për Sigurimin e Atdheut, përkatësisht programit ndërkombëtar për parandalimin e armëve të shkatërrimit në masë.

Qëllimi i këtij donacioni është ngritja e kapaciteteve hetuese kriminale që Policia e Kosovës, FSK-ja etj, do t'i përdorin në

dogana dhe vende të tjera me qëllim të evitimit të hyrjes së armëve të rrezikshme të shkatërrimit në masë në Kosovë. Qëllimi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës është ndërtimi i një Kosove të fortë dhe me një jetë më të sigurtë për të gjithë, tha në fund zonja Kelly Degnan. Ndërsa gjeneral brigade Imri Ilazi, shef i Departamentit të Operativës dhe Trajnimeve, ka falënderuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës për ndihmën e vazhdueshme që po japin për Kosovën dhe FSK-në.

"Amerika vazhdimisht po na ndihmon jo vetëm me mjete teknike por edhe me trajnime, me qëllim të profesionalizimit të njësive të FSK-së. Këto ditë pjesëtarët e FSK-së, kanë kryer me sukses trajnimin në këto fusha, si: Parandalimi apo pengimi i përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, Detektimi i armëve të shkatërrimit në masë, Ndalimi i armëve të shkatërrimit në masë, Materialet dhe pajisja teknologjike në lidhje me armatimin e shkatërrimit në masë, hetimi i trafikut ilegal, si dhe reagimi ndaj armëve të

shkatërrimit në masë etj. Me këtë rast, gjeneral Ilazi ka falënderuar edhe instruktorët nga ICP-ja, për angazhimin maksimal që kanë bërë për aftësimin dhe përgatitjen e forcave profesionale të FSK-së, së bashku me Policinë e Kosovës dhe Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave, Doganën e Kosovës, Agjencinë për Mbrojtjen nga Rrezatimi Jonizues etj. Përdorimin i pajisjeve si dhe zhvillimi i disa ushtrimeve simulative i ka bërë pjesëtarët e FSK-së të jenë në një nivel të lartë profesional dhe të aftë që në vendin tonë të përballen me sukses kundër kërcënimit të armëve të shkatërrimit në masë.

Gjeneral Ilazi premtoi se, të gjitha pajisjet e dhuruara nga Qeveria Amerikane, do t'i përdorim dhe do t'i mirëmbajmë me sukses. Në fund gjeneral Ilazi në shenjë respekti dhe falënderimi për SHBA-në, zëvendës ambasadores Kelly Degnan i dhuroi emblemën e FSK-së, e cila e falënderoi për këtë dhuratë të veçantë. Vlera e pajisjeve për FSK-në, kap shumën prej 142 mijë dollarësh, ndërsa pjesa tjetër për Policinë e Kosovës dhe agjencitë tjera të sigurisë. Qeverinë amerikane e kanë falënderuar edhe Fehmi Fejza nga AMRK-ja si dhe Dejan Jankoviç, nga Policia e Kosovës.



Për arritje të jashtëzakonshme nderohen me medalje 26 oficerë të FSK-së

## Komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Kadri Kastrati shpërblen me medalje pjesëtarët e kësaj force për rezultatet e treguara në operacionet brenda dhe jashtë vendit



Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë të Kosovës u mbajt një ceremoni, për ndarjen e medaljeve, për pjesëtarët e FSK-së, që kanë arritur rezultatet të shkëlqyeshme në trajnime dhe operacione ushtarake të mbajtur në Krivollak të Maqedonisë, në Nijmegdan të Holandës dhe në intervenimin në shpellën e Zgatarit, komuna e Prizrenit. Komandanti i FSK-së gjenerallejtnant Kadri Kastrati me këtë rast i ka përgëzuar pjesëtarët e

FSK-së: kadetët e Qendrës së Studimeve Universitare të FSK-së, të cilët u shpallën më të mirët gjatë pjesëmarrjes në operacionin dyjavor, të mbajtur në poligonin ushtarak, Krivollak të Maqedonisë, pjesëtarët e njësive së kërkim-shpëtimit, të cilët zunë vendin e parë, në Holandë, dhe pjesëtarët që intervenuan në nxjerrjen e trupit të pajetë, nga një shpellë, në komunën e Prizrenit.

Me këtë rast komandanti i FSK-së

gjeneral Kastrati i ka përgëzuar pjesëtarët e FSK-së, për arritje të jashtëzakonshme në trajnimet dhe operacionet ushtarake që morën pjesë. Me këtë rast tha gjeneral Kastrati: "Ju në operacionet që keni marrë pjesë jashtë Kosovës, keni treguar një performancë të shkëlqyeshme, me çka jeni bërë shembull, dhe kjo është dëshmi, se FSK-ja është e

aftë të t'i kryejë me sukses të gjitha detyrat. Na gëzon fakti, se këto ditë, nga Gjermania u kthyen edhe 90 nënoficerë të FSK-së, të cilët treguan një performancë të lartë, me çka është edhe një hap para në plotësimin objektivave tona. Ndarja e medaljeve është edhe një përgjegjësi shtesë, por edhe motivim më i madh për realizimin me sukses të të gjitha

detyrave dhe për profesionalizimin e FSK-së, që është edhe synim i yni, për të ardhmen". Në fund, komandanti i FSK-së gjeneral Kastrati së bashku me zv. komandantin e KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrollin, u dhanë 26 pjesëtarëve të FSK-së medaljet me motivacionin për arritje të jashtëzakonshme profesionale në realizimin e detyrave.





Kompania e Deminimit vazhdon pastrimin e territorit nga mjetet e pashpërthyer

## Çminuesit e FSK-së pastruan mbi 60 mijë m<sup>2</sup> dhe shkatërruan mbi 200 mjete eksplozive

Kompania e Deminimit të FSK-së, gjatë këtij viti, ka arritur të bëjë pastrimin e mbi 60 mijë m<sup>2</sup> të territorit të minuar si pasojë e luftës, në Kosovë dhe të shkatërruar mbi 200 predha të llojeve të ndryshme, si: projektilet, granata dore, mortaja, raketa, bomba-kasetë, mina të ndryshme etj.

Ekipe të Kompanisë së Deminimit të FSK-së, po pastrojnë këto vendndodhje; në kazermën e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, në Ferizaj, në Harilaq, komuna e Fushë-Kosovës, në Hajvali, komuna e Prishtinës, si dhe pastrimin e fushëbetëve (BAC) dhe lokacioneve, në: Koshare dhe në Belincë, ndërsa një tog i EOD-së, kryen shërbime kujdestarie çdo 24 orë. Ekipe të Deminimit të FSK-së, këtë vit, kanë pastruar një sipërfaqe prej 60649 m<sup>2</sup> dhe kanë shkatërruar mbi 208 MEP (mjete eksplozive të pa shkatërruara) të llojeve të ndryshme, si: projektilet, granata dore, mortaja, raketa, bomba-kasetë, mina të llojeve të ndryshme etj.

Ekip EOD-së, në përgjigje të thirrjeve gjatë kujdestarisë, ka shkatërruar mbi 500 MEP të llojeve të ndryshme, si: projektilet, granata dore, mortaja, raketa, bomba-kasetë, mina të ndryshme.

Ekipe të Kompanisë së Deminimit po i përballojnë me sukses temperaturat e larta, megjithëse pajisjet mbrojtëse në trup janë mjaft të rënda dhe kjo ua

vështirëson edhe më shumë kushtet e punës.

Të udhëheqësh Kompaninë e Deminimit është privilegj, por në të njëjtën kohë është edhe përgjegjësi e madhe dhe rrezik për pjesëtarët e deminimit, mirëpo falë profesionalizmit të tyre, punës që po e bëjnë me përkushtim, kanë arritur që të pastrojnë një sipërfaqe të madhe të zonave të rrezikshme, kanë gjetur shumë mjete të pashpërthyer dhe nuk ju ka ndodhur asnjë incident. Ky përkushtim i tyre na bënë të gjithëve të ndihemi krenarë për ta.

Kompania funksionon si një kolektiv i përgjithshëm ku të gjitha aktivitetet janë të harmonizuara sipas zinxhirit komandues. Kujdes i veçantë po i kushtohet edhe ngritjes profesionale të pjesëtarëve të kompanisë. Një pjesëtar i saj po shkollohet në Gjermani. Të gjithë pjesëtarët e Kompanisë së Deminimit meritojnë dekorata, avancime etj.

Mjetet të cilat përdoren gjatë kryerjes së operacioneve të deminimit janë të përshatshme dhe janë në gjendje të mirë. Gjendje jo fort e mirë i përcjell mjetet e transportit pasi që nuk ka numër të mjaftueshëm të automjeteve si dhe disa prej tyre që posedojmë janë mjaft të amortizuara. Megjithatë falë profesionalizmit të pjesëtarëve të deminimit deri më sot nuk kemi pasur asnjë incident gjatë punës.



Pjesëtarët e FSK-së donatorë të rregullt të dhurimit të gjakut

## FSK -ja dhuroi mbi 450 doza gjak

Dr. Safete Maliqi nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, tha: "Pjesëtarët e FSK-së janë donatorë të rregullt të gjakut dhe se çdoherë i janë përgjigjur me vullnet këtij aksioni".

Në ambientet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), filloi aksioni humanitar për dhurimin gjakut, nga Departamenti i BCU-së dhe të Mjekësisë të MFSK-së, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës (QKTGJK), aksioni është mbajtur në të gjitha kazermat e njësive të FSK-së dhe ka zgjatur dy javë, nga data 2 deri me 16 korrik 2012.

Për t'i inkurajuar të tjerët me shembullin e tyre, në sallën e improvizuar për punën e ekipeve të transfuzionit, dhuruan gjak zëvendësministri i FSK-së, Bejtush Gashi dhe ushtruesi i detyrës së komandantit të Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli.

Zëvendësministri Gashi tha se FSK-ja ka një traditë të organizimit të aksioneve humanitare për dhurimin e gjakut dhe se prej praktikave të kaluara, por edhe prej interesimit që të gjithë po shohim sot këtu, FSK-ja, përkatësisht pjesëtarët e saj civilë dhe ushtarakë janë të gatshëm që të dhurojnë gjak për nevojat e pacientëve.

Po ashtu edhe gjeneral brigade Gëzim Hazrolli u shpreh se pjesëtarët e FSK-së janë shumë entuziast në përgjigje të këtij aksioni. Shumica prej tyre tha ai, janë dhurues të rregullt jo vetëm gjatë aksionit, por gjatë gjithë vitit.

Ndërsa Sabrije Prekaj, menaxhere për aksione të dhurimit të gjakut të QKTGJK-së, thotë se pjesëtarët e FSK-së janë donatorë të

rregullt dhe se çdoherë i janë përgjigjur me vullnet këtij aksioni.

Gjatë aksionit dyjavor, të mbajtur në të gjitha njësitet e FSK-së, janë dhuruar mbi 450 doza gjak për nevojat e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.

Ekipi mjekësor i Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut në bashkëpunim me personelin e Kompanisë së Mjekësisë së FSK-së, vizituan të gjitha kazermat e FSK-së sipas kalendarit, për të ju mundësuar pjesëtarëve që të dhurojnë gjak pa shpëputje nga detyrat dhe aktivitetet e punës.

Ky aksion organizohet për herën e katërt. Përkundër kohës së pushimeve, trajnimeve dhe ushtrimeve, thirrjes për gjak iu përgjigjen një numër i madh i pjesëtarëve të FSK-së. FSK-ja është dhuruesi më i madh i gjakut në Kosovë.

Pjesëtarët e FSK-së janë bërë një shembull i mirë për të ndihmuar qytetarët e Kosovës dhe për ngritjen e vetëdijes tek qytetarët që t'i përgjigjen aksionit humanitar për dhurimin e gjakut si dhe aksioneve dhe iniciativave të tilla humanitare.

Dr. Safete Maliqi, shefe në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, është shprehur e kënaqur me dozat e dhuruara të gjakut nga pjesëtarët e FSK-së duke u shprehur: "FSK-ja është donator i rregullt i dhurimit të gjakut dhe se çdoherë i janë përgjigjur me vullnet aksioneve të dhurimit të gjakut. FSK-ja dhe nxënësit janë dhuruesit më të mëdhenj të gjakut në Kosovë".

Aksioni humanitar i dhurimit të gjakut është realizuar në bashkëpunim BCU-së, Kompanisë së Mjekësisë së FSK-së dhe të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.



## Në Ministri të FSK-së u mbajt seminari: Politikat për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore

Në organizim të Zyrës për Minoritete në Ministrinë e FSK-së, u mbajt seminari nga Grupi Punues për Çështje Gjinore me temën: Eksperienca për barazi gjinore dhe të drejtat e njeriut.



Takimin e hapi dhe udhëhoqi Azemina Qullum, shefe e Zyrës për Komunitete dhe Barazi Gjinore në MFSK. Punimet e seminarit i përcolli zëvendësministri i FSK-së Sllavisha Filipoviq. Në takim morën pjesë përfaqësuesit e drejtave të njeriut, të ministrisë, KFT-së, dhe të njëjstëve të tjera të FSK-së, si dhe edhe përfaqësues të NATO-s. Çështjet kryesore të seminarit, të cilat u shtjelluan, ishin: Krijimi i mekanizmave institucionalë për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, bazuar në legjislacionin e aplikueshëm dhe politikat aktuale, realizimi i bilancit të gjinive dhe komuniteteve, rritja e besimit duke forcuar rolin e gruas dhe komuniteteve në MFSK dhe

FSK dhe zhvillimi i sistemit të informimit dhe bashkëpunimit me organizata relevante ndërkombëtare në MFSK dhe FSK. Ndërsa, nënkoloneli kanadez, Wayne Gauthier, në temën e tij "Përvojat e një kanadezi" prezantoi përvojat e të drejtave të njeriut në Ushtrinë e Kanadasë. Nënkoloneli Wayne Gauthier u ndal kryesisht të drejtat e njeriut në Ushtrinë e Kanadasë, siç janë raporti i të drejtave të njeriut, gjuha, pjesëmarrja e gjinisë femërore në ushtri, të drejtat e pakicave etj. Pjesëmarrësit e seminarit u angazhuan maksimalisht me pyetjet dhe interesimin e tyre për të ditur më shumë për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore në ushtrinë e Kanadasë.

## Fondi i Mirëbesimit dhuron donacion për FSK-në

Fondi i Mirëbesimit "Trust Fond" i themeluar nga vendet anëtare të NATO-s, për ngritje dhe ndihmë për FSK-në, ka ndarë një donacion në formë të pajisjeve të mirëmbajtjes së automjeteve për Batalionin e Logjistikës të Brigadës për Mbështetje Operacionale të FSK-së. Ky donacion i radhës që vjen nga "Fondi i Mirëbesimit" është shumë i dobishëm për punën e Batalionit të Logjistikës. Në këtë kontingjent përfshihen: mjete dhe vegla për ndërtim-tari, komplete mekanike, mjete hidraulike, aparatë diagnostike portative për defekte në makina, kompresor pneumatik, balancues të gomave të mëdha për makineri të rëndë, matës

laserik të distancës, etj. Pajisjet teknike të përfituara nga FSK-ja, janë të vlefshme për nevojat aktuale të FSK-së për aktivizimin dhe përdorimin efikas të mjeteve transportuese, teknikës dhe makinerisë së rëndë në kryerjen e detyrave dhe arritjen e objektivave të caktuar të plotësimit të Kapaciteteve të Plota Operacionale në kuadër të misionit saj. Fondi i Mirëbesimit është një kontribuues shumë i madh për pajisjen dhe mbështetjen e FSK-së, dhe se burim i financimit të këtij fondi janë shtetet anëtare të NATO-s, të cilat janë duke kontribuar në ngritjen dhe zhvillimin e FSK-së.

Holanda dhuron pajisje sportive për pjesëtarët e FSK-së

## Brigada për Reagim të Shpejtë në Istog, përfitoi donacionin në vlerë prej 15 mijë euro

Zëvendës komandanti i Forcave Tokësore (KFT) të FSK, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, pranoi donacionin në pajisje sportive për sallën e sporteve të Kazermës "Ushtarët e NATO-s" të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) në Istog. Donacionin u nda nga Mbretëria e Holandës për pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës të Komandës së BRSH-së dhe Batalionit të Dytë të Reagimit të Shpejtë në Istog. Gjatë përrurimit të sallës ku ishin vendosur pajisjet sportive, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli tha se Mbretëria e Holandës ka pas dhe vazhdon ta ketë një bashkëpunim shumë të mirë në të gjitha fushat e sidomos në trajnimin e pjesëtarëve të FSK-së e më konkretisht trajnimin për zhytës të pjesëtarëve të Kërkimit Shpëtim. Gjeneral Hazrolli



falënderoi shtetin e Holandës dhe nënkolonel Koedam për donacionin me pajisje sportive duke e cilësuar këtë donacion si një të mirë tjetër për pjesëtarët e FSK-së për të mbajtur dhe shtuar gatishmërinë fizike. Kurse atasheu ushtarak i

Holandës, nënkolonel Ton Koedam shprehu falënderimin e tij dhe të Qeverisë së Holandës e cila po vazhdon të ndihmojë FSK-në dhe falë këtij komunikimi dhe bashkëpunimi të mirë në mes të Ministrisë së FSK-së dhe Holandës kemi arritur rezultate të mirë në trajnime të ndryshme. Për donacionin e pajisjeve sportive Koedam tha se është kënaqësi që po kontribuojmë sadopak për t'i ndihmuar pjesëtarët e FSK-së të cilët kanë një motiv dhe fuqi për të vazhduar tutje synimet e tyre. Në përrurimin e kësaj sale ishte prezent zëvendës komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, komandanti i BRSH-së gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, atasheu ushtarak i Holandës Ton Koedam si dhe oficerë tjerë të FSK-së.



## Ministria për FSK mbështet QKUK-në dhe Policinë e Kosovës me Serum Antiviperik

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës, me vendim të ministrit Agim Çeku dhe Komandantit të FSK-së, gjeneral allejtënant Kadri Kastrati, ka mbështetur me Serum Antiviperik (tri doza), Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe Policinë e Kosovës, me kërkesë të tyre. Në ambientet e ministrisë u bë pranimit dorëzimi i dozave të serumit ndërmjet Major Dr. Genc Shala, zëvendës komandant i Kompanisë së Mjekësisë dhe përfaqësuesit të QKUK-së. Ndërsa një dozë i është dorëzuar sektorit të Mjekësisë së Policisë së Kosovës për shkak të nevojës urgjente që ishte krijuar me rastin e kafshimit nga gjarpri të një polici që kishte nevojë për Serum Antiviperik. Qendra Klinike Universitare ka paraqitur kërkesë për mbështetje me medikamentin Serum Antiviperik (që injektohet tek pacientet në raste të kafshimit nga gjarpinjët), tek sekretari i përgjithshëm i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Dr. Shkelzen Sylaj, me arsyetimin se Qendra Klinike Universitare e

Kosovës ka mungesë të këtij medikamenti e po ashtu as Ministria e Shëndetësisë nuk e posedon një medikament të tillë. Angazhim për koordinim dhe mbështetje ndërmori zëvendës ministri i Ministrisë së FSK-së, Shemsi Veseli i cili e vlerësoi si shumë fisnike ndihmesën që FSK-ja i bëri QKUK-së në këtë situatë. FSK-ja e ka konsideruar kërkesën imediate, dhe ka mbështetur QKUK-në me tri doza, sepse mungesa e këtij medikamenti në këto kushte të vërës, kur temperaturat janë të larta dhe se qytetarët mund të jenë të kërcënuar nga kafshimi eventual i gjarpërimit.

je, kërkon përgjigje të nevojshme. Ministria e FSK-së dhe FSK-ja e ka paraparë me kohë dhe çdoherë mban të furnizuar depon e medikamenteve të Kompanisë së Mjekësisë të FSK-së, për nevoja të ruajtjes së shëndetit të pjesëtarëve të FSK-së, të cilët janë të angazhuar në detyra të përditshme në terren, gjatë operacioneve, trajnimeve, aktiviteteve humanitare, etj. Sidomos në kushte verore FSK-ja ka marrë të gjitha masat që Serum Antiviperik të jetë në sasi të mjaftueshme për raste emergjente.

